

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” – Fakulteti Juridik

Niveli Master – Drejtimi Kushtetues Administrativ

Kandidati : Valmir Sadiku

Mentori: Prof. Ass. Dr. Flamur Hyseni

**Rastet e përfundimit të parakohshëm të mandatit të Qeverisë në Republikën e
Kosovës 2001-2021**

Punimin e temës e kam përqëndruar në Qeverinë e Republikës së Kosovës , si degë ekzekutive e cila është pozita më e rëndësishme në vendin tonë, ngase në kuadër të politikbërjes duke u bazuar në parimin e ligjshmërisë zbaton politika publike duke ekzekutuar vendime në interes të përgjithshëm.

Në këtë hulumtim kam analizuar rastet e ndërprerjes së parakohshme të mandatit të Qeverisë konkretisht të Kryeministrave, rrethanat e dërgimit të ndërprerjes së parakohshme të mandatit të parevokuar, dhe të revokuar bazuar në vendimet ligjore të rregulluara me Kornizën Kushtetuese të vetqeverisjes së përkohshme në Kosovë dhe Kushtetutës së Kosovës. Pra trajtimin e rasteve dhe periudhat kohore që kanë ndodhur, si ka qenë e përcaktuar me Kushtetutë apo me Kornizën Kushtetuese. Duke pas parasysh se do të trajtojmë dy periudha të ndryshme kohore ku kemi pasur rregullim juridik me Kornizën Kushtetuese nga viti 2001-2008 dhe pastaj nga viti 2008 – Kushtetuta e Kosovës. Këtë punim e kam ndarë në dy pjesë në pjesën e përgjithshme rregullimi juridik i përcaktuar me Kornizë Kushtetuese dhe me Kushtetutë, dhe në pjesën e veçantë rastet e ndërprerjes të mandatit të Qeverisë dhe Kryeministrave.

Sa i përket pjesës së përgjithshme kam bërë hulumtim lidhur me atë se si Korniza Kushtetuese dhe Kushtetuta e rregullojnë aspektin e funksionimit të qeverisë dhe rastet kur parashihet që përfundon mandatit i parakohshëm i Qeverisë dhe Kryeministrit, si zhvillohet kjo procedurë, a duhet të shkohet menjëherë në zgjedhje të reja, apo Presidenti/ja mundet që në rast se ka stabilitet politik të qeverisjes të kualicionit qeverisë të propozohet kandidati tjetër për Kryeministër, apo kjo e drejtë t’i kaloi partisë tjetër të dytës për nga fuqia politike e përfaqësimit në Kuvend. Të gjitha këto i kam analizuar sipas rregullimit kushtetues ligjor në bazë të Kushtetutës apo Kornizës Kushtetuese të Vetqeverisjes së Përkohshme.

Sa i përket pjesës së veçantë jam fokusuar tek rastet konkrete të ndodhura kur Kryeministrat dhe Qeveritë që kanë udhëhequr për rrethana të ndryshme të krijuara janë detyruar të ofrojnë dorëheqje të parevokueshme apo edhe i’u është revokuar mandati i tyre, dhe vendi në disa raste nuk ka shkruar në zgjedhje të reja por vetëm është zgjedhur Kryeministri i ri, sikurse në vitin 2005 kur Kryeministri z.Ramush Haradinaj jep dorëheqje të parevokueshme dhe vendi nuk shkon në zgjedhje por vetëm zgjedhet Kryeministri i ri z.Bajram Kosumi, por që kështu ka qenë e rregulluar edhe me akti më lartë juridik të asaj kohe Kornizën Kushtetuese. Gjithashtu kam trajtuar edhe rastet tjera të veçanta të ndërprerjes së parakohshme të mandatit të qeverisë pas vitit 2008 pas miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.